



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
VU644-24-7363-5-5-8/C899
14 Nr. 591/24
Dt. 28.08.2024

KONTRATË FURNIZIMI

Palët kontraktuese:

1. Komuna e Vushtrrisë, si Autoritet Kontraktues, të cilën e përfaqëson: **Ilmi Azemi – Drejtor i Drejtorisë për Prokurim Publik** (në tekstin e mëtejshëm **PORORSITËSI**), dhe
2. “ **Aritech** “sh.p.k. me seli në Prishtinë, me ARBK : **810821828**, të cilën e përfaqëson z. **Fahri Avdiu**, në tekstin e mëtejshëm: **FURNIZUESI**,

, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara me poshtë: **Furnizimi me Pajisje të Teknologjisë Informative**, me numër identifikues:

Nr. i prokurimit	VU644	2	4	73	6	3	5	5	8
Nr. iibrendshëm	UA/2016-	2	3	57	5	5	1	1	1/1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë : **Furnizimi me pajisje të teknologjisë informative për nevoja të drejtorive komunale, shkollave dhe institucioneve tjera siaps Kërkesave të Njësive Kërkuese të Autoritetit Kontraktues, në pajtim me Specifikat Teknike pjesë përbërëse e kësaj Kontrate.**

1.2 Kontrata hynë në fuqi me datën **29.08.2024** dhe përfundon brenda afatit jo më gjatë se **40 (dyzet) ditë** kalendarike pas datës së nënshkrimit të kontratës, respektivisht deri me datë **07.10.2024**.

1.3 Vendi i dërgimit do të jetë : **Në depon kryesore të Administratës Komunale në Vushtrri, në depon e Arsimit në Vushtrri dhe në depon e QKMF-së në Vushtri, sipas Regjistrit të Njësive Kërkuese të A.K. , në pajtim me Aneksin 1. Specifikimet Teknike të Detyrueshme, pjesë përbërëse e Dosjes së Tenderit dhe e kësaj Kontrate.**

1.4 Incotermi i aplikueshëm do të jetë **DDP¹** (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **84,509.00€ (Tetëdhjetekatërmijëpesqindemëntë/00 Euro).**

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës.

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pasi që Menaxheri i Kontratës dhe Komisioni i Pranimit të mallit të Autoritetit Kontraktues të konfirmoi me shkrim pranim-dorëzimin e pajisjeve, respektivisht pas dorëzimit të Raportit me shkrim se pajisjet janë dorëzuar – pranuar nga personat kompetent në institucionin në fjalë, si në aspektin sasior ashtu dhe në aspektin cilësor dhe të përshtatshmërisë. Raporti me shkrim i hartuar dhe nënshkruar nga Menaxheri i Kontratës dhe Komisioni i Pranimit të Mallit do të dorëzohet, një kopje Kontraktuesit dhe një kopje Drejtorisë për Prokurim me qëllim të procedimit me pagesat për furnizimet dhe / ose shërbimet e përfunduara.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i furnizimeve dhe / ose shërbimeve është përgjegjësi e Furnizuesit ndërsa pajisjet e dorëzuara duhet, në të gjitha aspektet, të plotësojnë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni për cilësinë e mallit do të mbetet përgjegjësi e furnizuesit.

Kontraktuesi me rastin e dorëzimit të mallit, duhet të dorëzojë sigurimin e kualitetit të mallit Dokumentin – Polisë të sigurimit apo dokument bankar të lëshuar nga ndonjë kompani e sigurimeve apo bank e licensuar nga Banka Qendrore e Kosovës, shuma e sigurimit të kualitetit prej 10 % e vlerës së përgjithshme të kontraktës me afat validiteti për kohëzgjatjen e periudhës prej 36 muajve, nga data e pranimit të mallit.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat respektivisht të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve dhe / ose shërbimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c) Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e) Falimenton; f) Është dënua nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Komerciale në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi



14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

14.2 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (c) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

E hartuar në gjuhën Shqipe në katër origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Autoritetin Kontraktues Komuna e Vushtrrisë		Për Kontraktuesin : “ Aritech “sh.p.k. – Prishtinë
Emri : Ilmi Azemi		Emri : Fahri Avdiu
Pozita : Drejtori i Drejtorisë për Prokurim Publik		Pozita : Drejtor
Nënshkrimi: 		Nënshkrimi: 
Data: 28.08.2024		Data: 28.08.2024
		v.v.



Shënimi 1: Te përshkrimi i gmimeve duhet plotësuar vetëm kolonat F dhe G

Në kolonën F ju duhet të plotësoni duke shkruar normën e TVSH-së, vetëm si numër 0, 8, apo 18, e jo në formatin 0%, 8% apo 18%. Ndërsa në kolonën G, duhet ta plotësoni me gminin për njësi me TVSH, po ashtu gminin duhet ta shkruani me dy decimale pas presjes dhjetore

Nr.	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi pa TVSH	Norma e TVSH-së në %	Çmimi për njësi (me TVSH)-€	Totali (Pa TVSH)	Totali (me TVSH)	Totali (me TVSH)-€	Shëno emërin e prodhuesit dhe modelit me të cilin ofertoni si dhe vendin prej ku do të bëhet furnizimi
1	Furnizimi me Monitor Brand Name - Modeli I - Sipas përshkimit në Aneksin nr.1	Copë	16	97.46	18.00	115.00	1,559.32	280.68	1,840.00	DELL E2222HS
2	Furnizimi me Monitor Brand Name - Modeli II - Sipas përshkimit në Aneksin nr.1	Copë	40	100.00	18.00	118.00	4,000.00	720.00	4,720.00	DELL E2424HS
3	Furnizimi me Shtepizë PC Brand Name - Modeli I - Sipas përshkimit në Aneksin nr.1	Copë	2	369.44	8.00	399.00	738.89	59.11	798.00	HP PRO TOWER 290 G9
4	Furnizimi me Shtepizë PC Brand Name - Modeli II - Sipas përshkimit në Aneksin nr.1	Copë	25	441.67	8.00	477.00	11,041.67	883.33	11,925.00	Lenovo Neo 50T
5	Furnizimi me Shtepizë PC Brand Name - Modeli III - Sipas përshkimit në Aneksin nr.1	Copë	32	738.89	8.00	798.00	23,644.44	1,891.56	25,536.00	HP PRO TOWER 290 G9
6	Furnizimi me Lap Top Brand Name - Modeli I - Sipas përshkimit në Aneksin nr.1	Copë	37	273.15	8.00	295.00	10,106.48	808.52	10,915.00	Lenovo V15 G4 IRU
7	Furnizim me Lap Top Brand Name - Modeli II - Sipas përshkimit në Aneksin nr.1	Copë	53	387.96	8.00	419.00	20,562.04	1,644.96	22,207.00	Lenovo V15 G4 IRU
8	Furnizimi me kompjuter All-in One Brand Name Modeli V - Sipas përshkimit në Aneksin nr.1	Copë	1	729.63	8.00	788.00	729.63	58.37	788.00	HP PRO ONE 440 G9
9	Furnizimi me kompjuter All-in One Brand Name Modeli VI - Sipas përshkimit në Aneksin nr.1	Copë	4	1337.96	8.00	1,445.00	5,351.85	428.15	5,780.00	HP ELITEONE 870 G9
TOTALI I PËRGJITHSHEM ME TVSH:							77,734.32	6,774.68	84,509.00	

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)

EMRI I OE:	Aritech SHPK
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE:	Fahri Avdiu
NËNSHKRIMI:	
DATA:	31.07.2024
VULA:	

